

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Jelena Krivokapić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

**H.. B. K. nga Peja, rr. ...,**

**I përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat Y. K. nga ...,**

Kundër:

**N/A**

Duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPPC/D/R/231/2014, të datës 13 Mars 2014 ,(lënda e regjistruar në AKP me numër KPA11715), në seancën e mbajtur me datë, 26 Nëntor 2020, merr;

### **AKTGJYKIM**

**Hedhet Poshtë si e pas afatshme, ankesa e parashtruar nga Hysen B. Kelmendi , kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/R/231/2014, të datës 13 Mars 2014, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP, me numër KPA11715.**

#### **Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;**

1. Me datë 22 maj 2007, H. K., ka parashtruar kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP-së), në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare (ABF), dhe sipas autorizimit në emër të vëllait të tij J. K., me të cilën ka kërkuar konfirmimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe kthimin e posedimit të pronës-objektit banesor,(shtëpi banimi), në sipërfaqe prej 29.00m2, e cila gjendet në ..., nr. ...(...), (tutje: prona e kërkuar).

2. Në formularin e kërkesës pala kërkuese,(tani e tutje, pala ankuese), deklaroi se ata e kanë shfrytëzuar pronën e kërkuar deri me datë 01.01.1995, kur ishin dëbuar me forcë dhe u ishte mohuar posedimi i më tutjeshëm nga pushteti i atëhershëm.
3. Në mbështetje të kërkesës, pala ankuese në AKP *inter alia*, ka paraqitur dokumentet si në vijim;
  - Vendimin nr. 617, të datës 08.12.1970, mbi ndarjen e banesës lëndore në shfrytëzim, bartësit të drejtës banesore J. K., të lidhur në mes tij dhe Ndërmarrjes banesore, "U...", me seli në Prizren.
  - Vendimin nr. ..., të dt.16.07.1990, lëshuar nga Departamenti i Urbanizimit dhe Çështjeve Banësore të K. Prizren, me të cilin i caktohej pagesa e qirasë në emër të vëllait të palës ankuese J. K., si bartës i të drejtës së shfrytëzimit të objektit banesor.
  - Vendimet e BVI-së për banim, lokale afariste, rregullim të tokës ndërtimore dhe rrugëve lokale të K. ..., nr.../..., dt, 07.06.1982, nr. .../..., i dt. 15.07.1984, dhe nr. ..., dt.25.02.1987, me të cilët bartësi i të drejtës së shfrytëzimit J. K., obligohej të paguaj kontributet si shfrytëzues i tokës ndërtimore të qytetit, për pronën e kërkuar.
  - Autorizimin nr. .../..., të dhënë nga J. K., me të cilin e autorizon vëllain e tij H. K. të ndërmarrë çdo punë juridike lidhur me paluajtshmërinë- banesën lëndore, "...", e cila gjendet në rr. Bul. ..., në ....
  - Fatura për pagesën e Energjisë elektrike, shfrytëzimit të ujit, Qirasë së banesës, fatura telefonie, në emër të bartësit të drejtës së shfrytëzimit të banesës lëndore J. K., për periudhën 1990-1993 ,si dhe Urdhërpagesën nr. ..., vitit 2001, në llogari të tij, për kontratën mbi shfrytëzimin e banesës.
4. Me datë 24 shtator 2008 nga AKP ishte bërë publikimi i kërkesës së palës ankuese për pronën lëndore, gjatë kësaj vizite objekti ishte gjetur të jetë shtëpi banimi në të cilën banonte M.T., i cili ishte prezent. I njëjti e nënshkruan formularin e njoftimit për pjesëmarrje në procedurë në AKP. Po ashtu Notifikimi i kësaj prone sipas koordinatave, ishte bërë me datë 08 qershor 2011, dhe ishte gjetur gjendje e njëjtë. Pala përgjegjëse M. T., nuk kishte pretenduar të drejtë ligjore, ai kishte deklaruar se shtëpinë e shfrytëzon për banim me lejen e palës ankuese H. K.i

. Ai po ashtu kishte deklaruar se paguan qira në AKP, për shfrytëzimin e pronës lëndore, sipas lëndës DS-308296.

5. Me datë 10 shkurt 2014, AKP-ja kishte kontaktuar bartësin e të drejtës së shfrytëzimit J.K., i cili kishte konfirmuar se prona e kërkuar i ishte ndarë atij, në te kishte jetuar deri në vitet 80-ta, pastaj ishte shpërngulur në Prishtinë, ndërsa prej vitit 1999, jeton në Mal të Zi . Ai po ashtu kishte konfirmuar se pala ankuese H. K. është vëllai i tij dhe sqaron se ai e ka pas në shfrytëzim shtëpinë gjer në vitin 1995, kur ishte dëbuar nga ajo.
6. Sekretaria e AKP-së kishte gjetur se për pronën e njëjtë sipas kërkesës së kategorisë “C”, të M. A., e kontestuar nga pala përgjegjëse J. K., Komisioni për Kërkesa Pronësore, Banesore, (HPD), me vendimin e tij, HPCC/D/220/2005/C të dt. 22 tetor 2005, kishte miratuar kërkesën e palës kërkuese M. A. dhe atij i ishte kthyer posedimi i pronës lëndore . Kërkesa për rishqyrtim të këtij vendimi u ushtruar nga pala ankuese, ishte refuzuar nga shkalla e dytë, me vendimit tjetër HPCC/REC/81/2006, të dt. 11 dhjetor 2006.
7. Me datë 13 mars 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës, (në tekstin e mëtejme: KKPK), përmes Vendimit të tij KPCC/D/R/231/2014, (në tekstin e më tejme: Vendimi i KKPK-së), ka vendosur që kërkesa e palës kërkuese,(tani ankuese) H. K., të hedhet poshtë. Në arsyetimin e vendimit grupor, (paragrafë 24 për kërkesën konkrete, dhe 26 kërkesa tjera të ngjashme), KKPK ka konstatuar se, bazuar në dokumentet e paraqitura nga paraqitësi i kërkesës, kërkimeve *ex officio*, nga sekretaria e AKP-së dhe deklarata e vetë paraqitësit të kërkesës, ka dështuar të demonstrojë se kërkesa lidhur me pronën e kërkuar ka të bëjë me humbjen e pronësisë si rezultat i rrethanave që drejtpërdrejtë ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i viteve 1998/99. Prandaj kërkesa bie jashtë mandatit të KKPK-së.
8. Vendimi i KKPK-së, i është dorëzuar palës ankuese, me datë 13 Maj 2014.
9. Kjo lëndë në AKP është mbyllur si jo e kontestuar, me datë 20 tetor 2014.

10. Me datë 02 gusht 2018 për mes postës “R”, kundër vendimit KPCC/D/R/231/2014, të dt. 13.03.2014, sa i përket kërkesës KPA11715, ankesë ka ushtruar pala ankuese për mes përfaqësuesit të tij sipas autorizimit avokat Y. K..

**Pretendimet e palës ankuese;**

11. Pala ankuese vendimin e ankimuar e konteston si jo konkret dhe përmbajtjesor lidhur me kërkesën e vendosur të palës ankuese, tutje thekson se; paraqitësi i kërkesës në AKP H. K., është i autorizuar nga vëllai i tij J. K., të cilit i është ndarë në shfrytëzim banesa në baza ligjore, sipas vendimit nr. 617, të dt. 08.12.1970, që sipas ligjit të atëhershëm ai e ka fituar të drejtën të cilit asnjëherë nuk i është marrë apo mohuar, se tani në gjykatën themelore në Prizren zhvillohet procedura jo kontestimore, sipas lëndës CN.nr. 162/14, për blerjen e banesës sipas propozimit të J. K..
12. Në fund propozon që gjykata supreme të aprovoj ankesën e tij, të ndryshoj vendimin e ankimuar dhe të merr vendim me të cilin të vërtetohet se ,poseduesi i të drejtës banesore J. K. është pronar i banesës kontestuese.

**Arsyetimi ligjor;**

**Pranueshmëria e ankesës,**

13. Ankesa është e pa pranueshme, sepse është paraqitur pas afatit të paraparë ligjor.
14. Neni 12.1, i Rregullores 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, (në tekstin e mëtejme “Ligji nr. 03/L-079”), përcakton si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”*.

15. Nga shkresat e lëndës provohet se pala ankuese e ka pranuar Vendimin e KKPK-së, me datë, 13 Maj 2014, kurse ankesë kundër këtij vendimi për mes përfaqësuesit të tij, avokat Y. K., ka paraqitur me datë 02 gusht 2018, për mes postës “R”, (data e vendosur sipas vulës së protokollimit dhe pranimit në Posta-Prizren 1, R ..., bar. Cod. \*6390513\*). Pas llogaritjes së afatit nga dita e paraqitjes së ankesës, vërtetohet se ankesa është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj 30 ditë, nga dita e pranimit të Vendimit të KKPK-së.
16. Nga faktet e vërtetuara, gjykata gjen se dorëzimi i vendimit të ankimuar është bërë në përputhje me nenin 111.1, të Ligjit nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/2008). Pala ankuese nuk ka theksuar ndonjë arsye dhe nuk ka paraqitur ndonjë provë me ankesë, për paraqitjen me vonesë të ankesës. Gjithashtu gjykata në shkresat e lëndës nuk ka gjetur prova të justifikueshme që e arsyetojnë vonesën e ushtrimit të ankesës nga pala ankuese.
17. Në bazë të asaj që u tha më lart, rrjedhimisht Gjykata Supreme nuk ka mundur t'i shqyrtoj arsyet e ankesës dhe të vendosi meritorisht në këtë çështje, prandaj në përputhje me nenin 13.3.(b), të Rregullores 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, dhe nenin 195, paragrafin 1, (a), të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore ;**

18. Sipas nenit 13.6 të Rregullores, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë, nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**GSK-KPA-A-015-2018, me datë 26 Nëntor 2020**

**Bashkp. Profesional,  
Sherif Krasniqi**

**Kryetari i Kolegjit,  
Ragip Namani**